

# SAFEGUARDING - TË NDIHEMI TË SIGURTË

Broshurë në gjuhë të  
thjeshtë



**Caritas Shqiptar**  
Albania



Falënderojmë të rinjtë e Shkollës Speciale  
3 Dhjetori, Shkodër

Grupi kontrollues:

Visar Quku

Igli Ymeri

Aurora Reçi



© European Easy-to-Read Logo: Inclusion Europe.

Për më shumë informacion:

[www.inclusion-europe.eu/easy-to-read](http://www.inclusion-europe.eu/easy-to-read)

Gjuhë e thjeshtë do të thotë që teksti është i kuptueshëm dhe i arritshëm për të gjithë, pavarësisht nga aftësia e kufizuar apo pengesa të tjera për të kuptuar.


# Informacion i rëndësishëm për marrësit e shërbimeve të Caritas



Caritas ndihmon njerëzit në nevojë.



Njerëzit që ndihmon Caritas nuk paguajnë për ndihmën e marrë.



Për Caritas të gjithë njerëzit janë njësoj.



Ti mund të pyesësh cila është puna e Caritas.

Ti ke të drejtë të ankohesh për punën e Caritas.

Ti ke të drejtë të marrësh përgjigje.



Stafi i Caritas nuk mund të kërkojë:

- para (lek)
- dhurata
- favore




# Informacion i rëndësishëm për fëmijët

## Stafi i Caritas:



- nuk duhet t'ju godasë
- nuk duhet të bërtasë
- nuk duhet t'ju prekë
- nuk duhet t'ju mërzisë dhe ofendojë
- nuk duhet të udhëtojë vetëm me ty në makinë
- nuk duhet të ftojë në shtëpinë e tij.



Nëse stafi i Caritas të bën diçka të keqe ose të ofendon, thuaja një personi të afërt.



Nëse stafi i Caritas të thotë mos i thuaj askujt se çfarë ndodhi mos e dëgjo.

Thuaja një personi të afërt që i beson. Ti duhet të jesh i sigurt.



Thuaj prindërve nëse dikush të lëndon.  
Thuaj prindërve ose rojes nëse dikush  
të prek në mënyrë që stë pëlqen.



Të gjitha këto thuaja shokëve të tu!



## Si të dërgosh një ankesë?



Caritas ka dokumenta që të mbrojnë ty.



Caritas ka një punonjës që merr ankesat.



Nëse dikush të shkel të drejtat e tua ti duhet të shkruash ankesë.

Informacionin tënd personal do ta dijë vetëm punonjësi që merr ankesat.



Të dhënat personale janë:

- emër mbiemër
- adresa
- numri i telefonit
- adresa e e-mail



Personi që merr ankesat nuk ja tregon askujt të dhënat e tua personale.

Nëse ju keni pyetje apo ankesa kontaktoni personin që pret ankesat në këto mënyra:



- Vendoseni ankesën tuaj në kutinë që ndodhet në Caritas
- Dërgo email në këtë adresë: [confidential@caritalbania.org](mailto:confidential@caritalbania.org)

MARS 2023

Enjte	Martë	Mirënjë	Nëntë	Hënë	Enjte	Shtunë
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

Caritas është i detyruar të përgjigjet ankesës tuaj brenda 30 ditëve.



Caritas Shqiptar e ka zyrën në Tiranë.

Caritas Shqiptar ka këtë adresë:  
Rruga Don Bosko, nr.4, Tiranë,  
Shqipëri.



Caritas Shqiptar është i hapur nga ora 8.00 deri në orën 4.00.



Për të përmirësuar punën tonë, ju lutemi vlerësoni tekstin. Këtë mund ta bëni duke skanuar kodin QR ose nëpërmjet linkut:

<https://forms.gle/U6jbFcMp4PdXwiUGA>



**Përgatitur: Caritas Shqiptar**

**[www.caritalbania.org](http://www.caritalbania.org) / +355 69 202 4596 /**

**[caritalbania@caritalbania.org](mailto:caritalbania@caritalbania.org)**

**Rruga Don Bosko, nr. 4, Tiranë, Shqipëri**